



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.27/2023


GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: [REDAKTUAR] kryetar i kolegjit, [REDAKTUAR] anëtar të kolegjit, në çështjen disiplinore, ndaj Hava Krasniqi, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, kundër Këshillit Prokurorial të Kosovës në Prishtinë (KPK), për shkak të shqiptimit të masës disiplinore, duke vendosur në procedurën e ankesës kundër vendimit të KPK-së, nr.487/2023, të datës 26 qershor 2023, në seancë të kolegjit të mbajtur më datë 01.08.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e paraqitur nga Hava Krasniqi, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, ndërsa vendimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës në Prishtinë, KPK/nr.487/2023, të datës 26 qershor 2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Këshilli Prokurorial i Kosovës në Prishtinë (KPK), me vendimin KPK/nr.487/2023, të datës 26 qershor 2023, në pikën I të dispozitivit ka vendosur: Aprovohet Raporti i panelit hetimor AD.nr.06/2023 dhe AD.nr.10/2023 të datës 21 qershor 2023, në rastin disiplinor të prokurores Hava Krasniqi, Prokuroria Themelore në Prishtinë. Në pikën II të dispozitivit është vërtetuar se prokurorja Hava Krasniqi për rastin AD.nr.10/2023, ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 dhe 2.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Në pikën III të dispozitivit vërtetohet se tek prokurorja Hava Krasniqi për rastin AD.nr.06/2023, nuk janë gjetur elementet e përgjegjesisë disiplinore në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Ndërsa në pikën III të dispozitivit prokurores Hava Krasniqi për rastin AD.nr.10/2023, i shqiptohet sanksioni disiplinor, “Zvogëlim i përkohshëm i pagës tridhjetë përqind (30%) për një vit” në përputhje me nenin 7



paragrafi 1 pika 1.3 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Kundër këtij vendimi prokurorja në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar vendimin për shkak të çështjes së gjykuar, zbatimit të gabuar të ligjit dhe për shkak shkeljeve procedurale të përcaktuara me ligj, me propozim që: Gjykata e Supreme e Kosovës ankesën e subjektit hetimor ta aprovoj si të bazuar, të anuloj vendimin e Panelit Hetimorë të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK.nr.487 të datës 26.06.2023, i protokolluar sipas numrit 1031/2023 me datë 03.07.2023 për shkak të çështjes së gjykuar ose të anuloj vendimin e Panelit Hetimorë të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK.nr.487 të datës 26.06.2023, i protokolluar sipas numrit 1031/2023 me datë 03.07.2023 për shkak të mungesës së përgjegjësisë së prokurores znj. Hava Krasniqi, ashtu që prokuroren ta liroj nga përgjegjësia disiplinore dhe të hudhen raportet e Panelit Hetimorë AD.nr.10/2023 për shkak të çështjes së gjykuar.


Me përgjigje në ankesë, KPK ka propozuar që ankesa e paraqitur të refuzohet ndërsa vendimi i atakuar të mbetet në fuqi.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me vendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka gjetur se:

Ankesa e prokurores është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se KPK, më datë 28 mars 2023, ka pranuar kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor nga Autoriteti Kompetent me pretendimin se Hava Krasniqi – Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, ka vepruar në shkelje disiplinore nga neni 6, paragrafi 2, pika 2.5 dhe 2.1 dhe neni 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Autoriteti Kompetent ka kërkuar nga KPK, si organ kompetent të filloj hetimin disiplinor dhe ka propozuar që ndaj të njëjtës për rastin AD.nr.06/2023 të shqiptohet sanksioni disiplinor vërejtje jo publike me shkrim e përcaktuar me nenin 7, paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Për kërkesën AD.nr.10/2023 ka propozuar që të njëjtës ti shqiptohet sanksioni disiplinor zvogëlim i përkohshëm i pagës deri në pesëdhjetë për qind (50%) për një periudhë deri në një (1) vit, e përcaktuar me nenin 7 paragrafi 1 pika 1.3 të Ligjit të lartcekur.


Kërkesës së lartcekur, Autoriteti Kompetent ia ka bashkangjitur shkresat e lëndës me shenjën AD.nr.06/2023 dhe AD.nr.10/2023, në të cilat pretendon se veprimet e prokurores nuk kanë qenë në përputhje me veprimet prokuroriale sipas kompetencës së prokurorit të shtetit.



Këshilli Prokurorial i Kosovës, me vendimin KPK-nr.322/2023, të datës 20 prill 2023, ka themeluar Panelin Hetimor për lëndën disiplinore – rastet AD.nr.10/2023 dhe AD.nr.06/2021. Paneli Hetimor më datë 14.06.2023 i ka paraqitur KPK-së, raportin me shkrim lidhur me hetimin e bërë për shkeljen e pretenduar. Në bazë të provave të paraqitura, fakteve të konstatuara, ballafaqimit të palëve, Paneli Hetimor nxjerr përfundimin se prokurorja Hava Krasniqi për rastin AD.nr.10/2023 ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 dhe 2.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Sipas panelit hetimor në rastin e raportuar të dhunës në familje prokurorja Krasniqi ka qenë kujdestare e rastit dhe përkundër të dhënave që i ka pasur për rastin nuk ka vlerësuar si duhet rrezikshmërinë e situatës, përkatësisht ka munguar vlerësimi i rrezikut pas raportimit të dhunës në familje, duke marrë për bazë faktin që i dyshuar L.S ishte recidivist, kishte dënim për vepër penale në vitin 2019, kishte urdhërbrojtje të lëshuar nga gjykata dhe dy deklarata për ushtrimin e dhunës ndaj viktimës, tani të ndjerës S.S. Është vlerësuar se prokurorja ka neglizhuar me rastin duke mos e ndaluar të dyshuarin por duke kërkuar nga policia që të nesërmen të dëgjohet në cilësinë e të dyshuarit dhe përkundër njoftimit nga policia për dëgjimin e të dyshuarit sërish nuk ka vlerësuar rrezikun e rastit por ka kërkuar që i dyshuari të lirohet në procedurë të rregullt. Nga këto arsye, Paneli Hetimor ka propozuar që të aprovohet propozimi i Autoritetit Përgjegjës - Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë që ndaj subjektit të hetimit – prokurores Hava Krasniqi të shqiptohet masa disiplinore Zvogëlim i përkohshëm i pagës deri në pesëdhjetë për qind (50%) për një periudhë deri në një (1) vit.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, pas shqyrtimit të raportit të panelit, dëgjimit të kryesuesit të panelit dhe subjektit të hetimit si dhe pas vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerrë vendimin e atakuar KPK.nr.487/2023 të datës 26 qershor 2023, me të cilin është konstatuar se prokurorja Hava Krasniqi është shpallur përgjegjëse për shkelje disiplinore për rastin AD.nr.10/2023 dhe i është shqiptuar sanksioni disiplinor duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të vendimit të atakuar, ndërsa për rastin AD.nr.06/2023 nuk janë gjetur elementet e përgjegjësisë disiplinore duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të atakuar.

Në arsyetim të vendimit të atakuar, KPK ka theksuar se: pas vlerësimit të provave të administruara, dëgjimit të kryesuesit të panelit, subjektit të hetimit si dhe shqyrtimit, analizimit, krahasimit të provave të cekura në raportin e panelit hetimor, për rastin AD.nr.06/2023 ka konstatuar se për prokuroren Hava Krasniqi nuk është vërtetuar shkelja disiplinore që bie në kundërshtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ndërsa për rastin AD.nr.10/2023 ka kryer shkelje disiplinore të përcaktuara me nenin 6 paragrafi 2 nënparagrafi 2.5 dhe 2.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.




KPK për rastin AD.nr.10/2023, ka konstatuar se prokurorja Hava Krasniqi është përfshirë në shkelje disiplinore të pretenduar nga autoriteti kompetent, ka dështuar në ushtrimin e profesionit të prokurorit, për shkak të neglizhencës së rastit, duke mos vlerësuar rrezikun pas raportimit të dhunës në familje e kështu duke mos ndërmarrë veprime hetimore nga data e raportimit të dhunës, prandaj me dështimin e ndërmarrjes së masave në kohë ka dështuar në mbrojtjen e jetës së të ndjerës S.S. Nisur edhe nga fakti që i dyshuari L.S ishte recidivist, kishte dënim për vepër penale në vitin 2019, kishte urdhër mbrojtje të lëshuar nga gjykata dhe dy deklarata për ushtrimin e dhunës ndaj viktimës, tani të ndjerës S.S. Prokurorja Krasniqi ka neglizhuar rastin duke mos ndërmarrë veprime hetimore nga data e raportimit të dhunës, përkatësisht 03 mars 2021 deri në vrasjen e të ndjerës me 14 mars 2021. Sipas Këshillit Prokurorial të Kosovës, arsyetimi i prokurores Hava Krasniqi se e njëjta nuk ka pasur njohuri se i dyshuari ka qenë recidivist dhe mungesën e deklaratave shtesë të dëmtuarës dhe ankueses, vajzës së tyre, refuzimi për vazhdimin e urdhrit mbrojtës dhe në aspektin se një i mitur iu ka besuar babait e që të gjitha këto kanë ndikuar për të vlerësuar që për momentin rasti të shkojë në procedurë të rregullt, nuk paraqet bazë për të përjashtuar përgjegjësinë disiplinore sepse si prokurore e çështjes ka qenë e detyruar fillimisht të vlerësoj rrezikshmërinë e rastit konkret dhe të ndërmarr veprime hetimore nga koha e raportimit të dhunës dhe mos vlerësimi të rrezikut real për tani të ndjerën, dështimin e marrjes së masave në kohë, ka dështuar në mbrojtjen e jetës së të ndjerës.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të vendimit të atakuar KPK, ju ka referuar nenit 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 dhe 2.1 dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Gjykata Supreme e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Këshillit Prokurorial të Kosovës është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që vendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, drejt dhe në mënyrë plotë është vërtetuar gjendja faktike, si dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Subjekti hetimor në ankesën e paraqitur pretendon se rasti i iniciuar nga Autoriteti Kompetent është çështje e gjykuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë me arsyetim se sipas raportit të datës 19.03.2021 të përgatitur nga znj. [REDAKTUAR] cila sipas ankesës/kërkesës për trajtimin e hetimit të kësaj çështje kishte konstatuar: “Prokuroria Themelore në Prishtinë nuk ka bërë asnjë lëshim” dhe si i tillë KPK nuk ka pasur kompetencë të vendosjes derisa raporti në fjalë është në fuqi, asnjëherë nuk është anuluar, ndryshuar apo modifikuar në asnjë mënyrë. Gjykata Supreme vlerëson se pretendimi i tillë është i pabazuar, kjo për faktin se në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë që dëshmon se në raport me subjektin e hetimit të jetë zhvilluar ndonjë procedurë disiplinore dhe të jetë marrë ndonjë vendim nga Këshilli Prokurorial apo gjykata në këtë



rast, respektivisht nuk është vërtetuar se ka pasur ndonjë vendim në raport me rastin e sipër cekur. Në mungesë të një vendimi që tregon se është trajtuar rasti i njëjtë, pra që ka të bëjë me rrethanat e njëjta faktike dhe juridike, në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, ashtu siç është pretenduar në ankesë.

Gjykata Supreme nuk ka pranuar as pretendimin ankimor për shkelje të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, kjo për faktin se procedura e zhvilluar në këtë çështje ka garantuar objektivitetin e procesit të hetimit, vlerësimin dhe ligjshmërinë e vendimmarrjes përmes vlerësimit të gjitha kërkesave dhe pretendimeve si në aspektin procedural por edhe në aspektin e zbatimit të drejtës materiale. Vendimi i atakuar është mjaft i qartë, i rregullt në strukturë dhe përmbajtje. Këshilli Prokurorial i Kosovës ka arsyetuar të gjitha faktet dhe ka vlerësuar pretendimet e subjektit të hetimit, nga ka ardhur në përfundim se prokuroja Krasniqi për rastin AD.nr.10/2023 ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 dhe 2.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, të cekur si në dispozitiv të vendimit të KPK.

Subjekti hetimor në ankesën e paraqitur pretendon se KPK ka zbatuar gabimisht ligjin duke vërtetuar gabimisht gjendjen faktike. Gjykata Supreme vlerëson se një pretendim i tillë është i pabazuar pasi që Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të provave të administruara në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se prokurorja Hava Krasniqi është përfshirë në shkelje disiplinore të pretenduar nga autoriteti kompetent, për shkak se nga provat që i ka pasur në dispozicion si: raportin fillestar të incidentit, raportin e oficerit, deklaratën e viktimës, deklaratën e dëshmitares, procesverbalin e marrjes në pyetje të dyshuarit, rezulton se prokurorja në fjalë ka bërë lëshime duke mos e trajtuar seriozisht rastin, respektivisht duke neglizhuar rastin, që më vonë ka rezultuar me vrasjen e viktimës S.S. Gjykata vlerëson se njoftimi nga policia për natën kritike që është ushtruar dhunë ndaj viktimës, deklarata e viktimës S.S, deklarata e vajzës së viktimës M.S se babai i saj – i dyshuari është duke bërë presion ndaj nënës së saj që një kohë të gjatë, tregojnë se prokurorja e rastit ka qenë në dijeni të fakteve dhe provave që kanë të bëjnë me sulmin ndaj viktimës, por që marrë për bazë faktet dhe provat e çështjes ka neglizhuar rastin dhe nuk ka arritur të vlerësojë si duhet rrezikshmërinë duke e liruar të dyshuarin në procedurë të rregullt.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e KPK-së, për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se me nenin 6 paragraf 2 nën paragraf 2.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, përcaktohet se: *“ Shkelja e detyrave të prokurorit sipas këtij ligji, përfshin veprimet e mëposhtme, në qoftë se prokurori kryen me dashje apo nga pakujdesia e rëndë: “në mënyrë të vazhdueshme nuk ndërmerr ndonjë veprim prokurorial që kërkohet me ligjin në fuqi ose nuk ushtron funksionet prokuroriale brenda afateve*




kohore të parapara me ligj, përveç nëse serioziteti i mos veprimit apo niveli i shkeljes paraqet bazë për iniciimin e procedurës disiplinore për një shkelje të vetme ”. Ndërsa me paragrafin 2.5 të të njëjtit nen si shkelje e detyrave të prokurorit përcaktohet se : “ nuk merr parasysh të drejtat e dëshmitarëve ose palëve të dëmtuara, veçanërisht për të marrë masa për të mbrojtur jetën, sigurinë dhe privatësinë e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi. Me nenin 7 paragraf 1 të këtij ligji përcaktohet se: “ Për shkelje disiplinore, këshillat përkatës mund ti shqiptojnë gjyqtarëve dhe prokurorëve një ose më shumë nga sanksionet disiplinore në vijim: 1.1. vërejtje jopublike me shkrim; 1.2. vërejtje publike me shkrim; 1.3. zvogëlim i përkohshëm i pagës deri në 50% për një periudhë deri në një vit; 1.4. transferim i përkohshëm ose i përhershëm në një gjykatë apo prokurori tjetër të nivelit më të ultë; 1.5. propozim për shkarkim ”, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se; “Masa disiplinore shqiptohen vetëm në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe duke marr parasysh: 2.1. numrin dhe seriozitetin e shkeljeve disiplinore të kryera nga një gjyqtar apo prokuror; 2.2. pasojat e shkeljes disiplinore; 2.3. rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore; 2.4. performanca dhe sjelljen e përgjithshme të gjyqtarit apo prokurorit dhe 2.5. sjelljen dhe nivelin e bashkëpunimit të gjyqtarit apo prokurorit gjatë procedurës disiplinore ”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata Supreme erdhi në përfundim se KPK, drejt ka aplikuar të drejtën materiale dhe se është konstatuar përgjegjësia disiplinore e prokurores së pretenduar nga Autoriteti Kompetent, për çka edhe i'a ka shqiptuar sanksionin disiplinor. Po ashtu, Gjykata Supreme vlerëson se sanksioni disiplinor i shqiptuar nga KPK, është në përputhje të plotë me parimin e proporcionalitetit për faktin se me rastin e vendosjes ka marrë parasysh seriozitetin e shkeljes disiplinore të kryer nga prokurorja, pasojat e shkeljes disiplinore, rrethanat në të cilën është kryer shkelja disiplinore, performanca dhe sjellja e përgjithshme e prokurores si dhe sjellja dhe bashkëpunimi i prokurores në procedurë disiplinore, rrethana këto që kanë ndikuar gjetjen e nivelit të proporcionalitetit, në mes të shkeljes disiplinore dhe masës disiplinore, siç përcaktohet me nenin 7 paragrafi 2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Nga arsyet e cekura Gjykata Supreme e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e duke u mbështetur në nenin 15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

A.A.nr.27/2023, me datë 01.08.2023



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJES E VËRTETON
ТАЧНОСТ ОТПРАВКА ПОТВРЂУЈЕ

Prokurori i autorizuar
Qytetar i ri i rethit

Kryetari i kolegjit

